



| | | | |
|--|--|-----------------------------------|--|
|  Republika e Kosovës Republika Kosovo | ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA OSOBLJA | |  Komuna e Istogut Opština Istok |
| | 02 Nr.148/19 | Data: 02.07.2019 | |

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 12, paragrafi 4, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Istogut shpall :

K O N K U R S

Për Kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

Drejtoria: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Titulli i vendit të punës : Zyrtar/e për Zhvillimin e Aktiviteteve Muzikore në Qendrën Kulturore

Lloji i pozitë: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (kohëzgjatja 6 muaj).

Numri i ekzekutuesve: 1 (një)

Numri i Referencës : 02Nr.148/19

Orari i plotë: 40 orë në javë

Niveli i Pagesës : 400

Detyrat dhe Përgjegjësit :

1. Të merret me aktivitetet muzikore kulturore;
2. Të ketë njohuri dhe së paku të ekzekutoi njëren nga këto vegla muzikore : fiz'harmonik, klarinet, piano, gitar, violinë, sintisaizer, etj;
3. Për nder të datave të shënuara, të organizoj programe muzikore;
4. Të organozoj festivale muzikore, për fëmijë dhe të rritur, në bashkëpunim me DKRS-të;
5. Të bashkëpunoj me grupe muzikore dhe asamble, për pjesëmarrje në manifestime që do mbahen mbrenda dhe jashtë vendit;
6. Të gjitha këto aktivitete të kryhen në bashkëpunim me DKRS-të;
7. Si dhe shërbime të tjera që rrjedhin nga natyra e aktiviteteve kulturore të paraqitura nga mbikëqyrësi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë konkurrimi në këtë pozitë kane shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Dokumentet:

- Dëshmi të kualifikimi shkollor: Akademia e Muzikës drejtimi instrumental
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dy rekomandime;
- Dokument identifikimi;
- Certifikata e lindjes apo ekstrakti;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;

Afati i Konkurimit: Konkursi është i hapur tetë (08) ditë kalendarike nga data e publikimit.


Data e shpalljes së konkursit: 02.07.2019 deri më 09.07.2019

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë "

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës "

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen



Menaxheri i Personelit

Fatmir Bytyçi